



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komune e Kaçanikut
Opština Kaçanik
Municipal of Kaçanik

01 Nr. 60/01-38152/21

Kaçanik, 29.12.2021

Në bazë të nenit 51 dhe 52 të Ligjit nr. 03/L-040 Për Vetëqeverisjen e Lokale, të nenit 3.1 dhe 2 lidhur me nenin 4, 5 dhe 6.4 të Udhëzimit Administrativ (MPL) Nr. 05/2020 – për procedurën e themelimit, përbërjen dhe kompetencat e komiteteve të përhershme dhe komiteteve tjera në komunë, të nenit 39.1 të Statutit të Komunës, Kuvendi i Komunës Kaçanik, në mbledhjen e vet të mbajtur me 29 dhjetor 2021, merr këtë:

V E N D I M

PËR FORMIMIN E KOMITETIT PËR POLITIKË DHE FINANCA


1. Me këtë Vendim, formohet Komiteti për Politikë dhe Financa (KPF) i Kuvendit të Komunës Kaçanik, nga radhët e anëtarëve të Kuvendit të Komunës, në përbërje 7 anëtarëve.
2. Komitetit për Politikë dhe Financa, ka këtë përbërje:

2.1. Kemal Murseli	PDK	Kryesues sipas funksionit
2.2. Kadri Krivenjeva	PDK	anëtar
2.3. Fitore Vishi	PDK	anëtar
2.4. Agim Mani	LVV	anëtar
2.5. Kadrije Lika-Troni	LVV	anëtar
2.6. Ardita Rrahmani	LDK	anëtar
2.7. Rabije Sallahi	AAK	anëtar.
3. Përbërja e Komitetit për Politikë dhe Financa reflekton përfaqësimin e etniteteve politike në Kuvendin e Komunës, duke reflektuar edhe barazinë gjinore.
4. Komiteti për Politikë dhe Financa kryesohet nga Kryesuesi i Kuvendit të Komunës, sipas funksionit që e ka. Në rastet kur në mbledhjen e komitetit për politikë dhe financa mungon kryesuesi, mbledhja kryesohet nga anëtari më i vjetër i komitetit.
5. Detyrat e Komitetit për Politikë dhe Financa janë të përcaktuara në Ligjin e Vetëqeverisjes Lokale, Udhëzimit Administrativ (MPL) Nr. 05/2020, Statutin e Komunës dhe në Rregulloren e Punës së Kuvendit.
6. Anëtarët e KPF nuk kanë të drejtë të jenë edhe anëtarë të komiteteve tjera.
7. Kompensimi për punën e Komitetit për Politikë dhe Financa rregullohet me Vendim të veçantë sipas Udhëzimeve të Qeverisë së Republikës së Kosovës.
8. Ky Vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të autoritetit mbikëqyrës -MAPL, si dhe 7 ditë pas publikimit në faqen zyrtare të komunës.

Me këtë Vendim njoftohen: Anëtarët e Komitetit për Politikë dhe Financa, Kryesuesi i Kuvendit, Kryetari i Komunës, Drejtoria për Ekonomi, Financa dhe Zhvillim dhe Arkivi.



Kryesuesi i Kuvendit
Kemal Murseli



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministartstvo Administracije Lokalne Samouprave
Ministry of Local Government Administration

Për:	Besim Ilazi, Kryetar i Komunës së Kaçanikut Kemal Mërseli, Kryesues i Kuvendit të Komunës së Kaçanikut
Kopje:	Njësisë për Administrimin e Dokumenteve në MAPL Njësisë për Administrimin e Dokumenteve në Komunë
Përmes:	Elbert Krasniqi, Ministër i MAPL-së Venera Çerkini, Zv Sekretare e Përgjithshme në MAPL
Nga:	Besim Myrtezani, Zv. Udhëheqës i Departamentit Ligjor dhe Monitorim të Komunave Datë: 11.01.2022 Nr.020-6
Zyrtaret përgjegjës:	
1. Zyrtari konfirmues i vlerësimit ligjor	Gëzim Sahiti, Zv. Udhëheqës i Divizionit për Monitorim të Komunave
2. Zyrtari hartues i vlerësimit ligjor	Vjosa Ahmetaj, Zyrtare e lartë për monitorim të komunave
Lënda:	Konfirmim i ligjshmërisë së aktit të Komunës së Kaçanikut
Lloji i aktit:	☐ Vendim i Kuvendit të Komunës

I nderuar Kryetar,
I nderuar Kryesues,

Në pajtim me Rregulloren e Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 06/2021 për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores (QRK) Nr. 10/2019 për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave, e në bazë të kompetencave ligjore të ministrisë të përcaktuara me ligjet bazike dhe Rregulloren e Qeverisë Nr. 02/2021 për Fushat dhe Përgjegjësitë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, Departamenti Ligjor dhe Monitorim të Komunave i Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal ka pranuar për shqyrtim të detyrueshëm të ligjshmërisë ashtu siç parashihet me nenin 81 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale aktin komunal në vijim:

Vendim i Kuvendit të Komunës 01 Nr. 60/01-38152/21 për formimin e Komitetit për Politikë dhe Financa
I miratuar më datë: 29.12.2021
I parashtruar për shqyrtim në MAPL më datë: 05.01.2022

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, pas shqyrtimit të përmbajtjes së aktit të komunës si më sipër, vlerëson se akti i komunës në aspektin procedural është në pajtim me dispozitat e legjislacionit në fuqi.

Sa i përket llogaritjes së përqindjes së përfaqësimit të subjekteve politike në komitetin për politik dhe financa mbetet në përgjegjësinë e Kryesuesit të kuvendit të komunës së bashku me subjektet politike të përfaqësuara në kuvendin e komunës ashtu siç përcaktohet me nenin 5 paragrafi 2 i Udhëzimit Administrativ Nr.05/2020, për procedurën e themelimit, përbërjen dhe kompetencat e komiteteve të përhershme dhe komiteteve tjera në komunë, të bëjnë llogaritjen e përfaqësimit në komitet për secilin subjekt politikë.

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal mbetet në dispozicion të komunës për çfarëdo sqarimi të mëtejshëm në lidhje me këtë vlerësim.